




shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

ISSN 1720-3678 00801



9 771720 367001

Vit i nxehtë për artistin më të famshëm shqiptar në botë që gjatë 2007-ës e ka parë veten protagonist të galerive më të mëdha të artit botëror, në Europë e përtej oqeanit, ku përveç dy personaleve ende të hapura, në Museum of Modern Art përfaqëson Italinë mes tetë artistëve më me influencë në artin bashkëkohor

Adrian PACI

artisti global



WESTERN UNION
MONEY TRANSFER

Vodafone One Nation

Life is now

Kush është larg nuk ka qenë asnjëherë kaq afër.





Listës së gjatë të çmimeve të artistit shqiptar me banim në Milano i shtohet edhe çmimi Pino Pascali 2007. Vit i nxehtë për Adrian Pacin, që gjatë 2007-ës e ka parë veten protagonist të galerive më të mëdha të artit botëror, në Europë e përtej oqeanit, në Amerikë, ku përveç dy personaleve ende të hapura, në Museum of Modern Art (Moma) përfaqëson artin bashkëkohor italian mes të të artistëve më me influencë në botë



Adrian Paci është emri shqiptar absolutisht më i rëndësishëm në botën e artit bashkëkohor botëror. Arti i tij, një krijim eklektik që përdor e ndërthur të gjitha mjetet shprehëse duke u bërë diçka e pakategorizueshme dhe e papërkufizueshme për kornizat klasike të botëkuptimit të artit, arrin të shpreh qartë e të përcjellë në mënyrë mbresëlënëse mesazhe të arritshme nga çfarëdolloj syri që ndeshet me veprën. Kritikët e artit duke u munduar të skematizojnë veprimtarinë e tij e përfshijnë atë në kategori të parabëra e zvogëluese herë në të qenët shqiptar, herë në të qenët

ballkanas, herë në të qenët një artist migrues por para se të jetë të gjitha këto Paci është një artist në të gjitha kuptimet e fjalës që e përjeton artin e vet, duke parë te jeta atë që të tjerë nuk shohin, pikërisht siç e përkufizonte artistin Salvador Dali. Ka shumë Shqipëri në punët e tij, një Shqipëri e jetuar në përrallat e ngatërruara surrealistike që tregojnë vajza e tij e vogël, në "dialogun me vdekjen" që është vajtimi teatral i një vajtojece nga Shqipëria e Veriut, në përvojat e një Klodi, një të riu nga Shkodra që tregon në mënyrë karizmatike gjithë rravgimet e tij nëpër botë

gjatë viteve '90. Por me Shqipërinë ndërthuren edhe tema të universalizuara që mund të ndodheshin kudo, me tema që për personazh mund të kishin këdo. Është edhe një artist migrues që jeton tensionin, metamorfozën, atë procesin e vazhdueshëm të transformimit që është i vazhdueshëm herë herë i dhimbshëm por krijues, i pasur me vibrime, me nuanca ndjenjash e ndjesish, të një të jetuari në një gjendje "inbetweenness". Ky është një përkufizim i përgjithshëm i jetës siç mendonte Niçe, por është edhe gjend-

vijon në faqen 10



vijon nga faqja 9

ja tipike e migruesve, që marrin një pjesë të së kaluarës dhe të tokës prej nga vijnë dhe shkojnë drejt një realiteti të ri të panjohur duke u përkthyer disi të dyjave, siç duket të përcjellë në veprën "Back Home" Paci, ku familje të ndryshme migruese pozojnë përpara fotokameras së tij para fasadës së shtëpive që kanë lënë pas, realizuar në pikturë nga vetë artisti, apo në veprën e fundit "Centro di Permanenza temporanea" ku, gjendja "inbetween", merr formë konkrete, tejet shprehëse, një përkufizim pothuaj fizik të saj, ku në një aeroport ai fotografon një shkallë avioni të vetmuar në mes të aerodromit, pa asnjë avion ku të jetë lidhur por me njerëz që hipin dhe qëndrojnë aty, në një fazë ndërmjetësie të pazgjidhshme.

Veprat e tij gjenden në galeritë më në zë të artit bashkëkohor në gjithë botën, nuk mungon kurrë në eventet e rëndësishme botërore të kësaj sfere, dhe çmimet e fituara janë të panumërta. Më i fundit i takon vetëm para pak ditëve, kur çmimi që mban emrin e artisti të madh italian Pino Pascali, në edicionin e tij të njëmbëdhjetë iu dha Adrian Pacit. Kështu galeria me emrin e artistit italian në Bari do t'i shtohet listës së gjatë të galerive që në mbarë botën mikpresin vepra të Pacit.

INTERVISTA

“Arti im është përjetimi”

Shqiptari i Italisë: Adrian, në pak vite ke arritur majat e artit bashkëkohor duke eksperimentuar në të gjitha gjinitë, nga piktura deri te videoinstalacionet. Ti vjen sidoqoftë nga një formim klasik, madje madje nga shkolla ku mësohej realizmi socialist. Cili është procesi i rrugëtimit në botën e lartë të artit duke u nisur nga këto premisa?

Adrian Paci: Po unë kam studiuar në Tiranë gjatë periudhës kur sundonte akoma realizmi socialist. Shkolla e artit ndiqte modelin e shkollës sovietike e në përgjithësi bazohej në traditën klasike. Prirja e studentëve ishte që ta thyenin këtë skemë, për me synue diçka përtej rregullave, mirëpo duhet thanë se rregulla ishte aq e

vjetërueme, sa edhe rebelimi karshi rregullës ishte disi i vjetëruem. Kur unë kam studiuar pikturë në Tiranë në vitet '87-'91 tendenca jonë për t'i ikë modelit klasik që na ofrohej në shkollë frymëzohej nga kubizmi, fauvizmi, ekspresionizmi, arti metafisik, dhe piktorë si Picasso i periudhës blu, Chagall, de Chirico etj. Këta ishin emnat që ne i konsideronim si modele për të thye rregullat dhe ishin të gjithë emna që vinin nga fillimi i shekullit.



E pamundur të radhiten të gjitha ekspozitat ku Paci ka marrë pjesë gjatë vitit 2007. Ndër më të veçantat, që shënojnë ndoshta konfirmimin definitiv të artistit në skendën e artit botëror ndërkombëtar janë personalet në New York dhe përfaqsimi i Italisë me pjesëmarrjen mes tetë artistëve më “me influencë” në galerinë PS1 të Museum of Modern Art në New York (21 tetor 2007 deri më 7 janar 2008) krahas Vanessa Beecroft, Paolo Canevari, Angelo Filomeno, Rā di Martino, Paola Pivi, Pietro Roccasalva dhe Francesco Vezzoli. Vepra e tyre, shkruan kritika amerikane, përfaqëson talente të ndryshme, që nuk i përkasin një shkolle apo rryme të caktuar, pro që i bashkon vetëm një gjë, talenti unik.



“ Ndeshja e artistëve shqiptarë me artin bashkëkohor i ngjan në një farë mënyre kontaktit që shqiptarë kanë pasë me botën perëndimore pas viteve '90. Ka qenë një kontakt i mbushun me tensione, mbushun me dëshira, me iluzione e zhgënjime, nuk ka qenë një kontakt normal, por i kushtëzuar nga mungesa 50-vjeçare e marrëdhënieve me këtë pjesë të botës

Ndeshja me të rejtat ma të fundit në art ka ndodhë kur kam ardhë në Itali në '92, kur kam pasë rast me vizitue s'pari muzetë e artit bashkëkohor, Bienalen e Venecias, ekspozitat në galeri të ndryshme, apo kur më kanë ra në dorë revista që merreshin me të rejtat e fundit në artet vizive. Këto kontakte kanë nxjerrë në pah mangësitë që kishim nga shkolla shqiptare. Kurse përta i takon krijimtarisë sime, siç e kam thanë shpesh, një moment i fortë thyemje ka qenë ai me videon "Albanian Stories" ku vajza ime 3-vjeçare tregon përralla duke përzi kafshët, me forcat e errëta, luftën dhe me njerëzit që ikin. Ajo përvojë nuk kishte të bante thjesht me artin në vetvete, por me intensitetin e vet jetësor më shtyni me i vu ne diskutim mjetet e mia tradicionale duke nxjerrë si te nevojshme përdorimin e videos. Aty kam pasë kontaktin e parë me videon. Nuk ishte një kontakt gradual siç mund të ndodhte po të kalonte për shembull nga piktura tek fotografia, tek një shkollë për video etj. Ishte një kontakt i rryeshëm e disi urgjent. Ndeshja e artistëve shqiptarë me artin bashkëkohor i ngjan në një farë mënyre kontaktit që shqiptarë kanë pasë me botën

vijon në faqen 12

Lart, një detaj nga cikli i pikturave "Ungjilli sipas Pazolinit" paraqitur nga Paci në Modena në personalen e tij "Raccontare".
Te Pasolini Paci gjen disa pika të përbashkëta përjetimi e përfaqësimi të realitetit : në mendimin pazolinian është qëndror sensi i shtëpisë si vend i shenjtë po ashtu siç është edhe çrrënjosja. Që të dyja këto tema janë konstante në punën e Pacit. Po ashtu në sens artistik, nëse kinemaja e Pazolinit kërkon poetikën e reales nëpërmjet pasqyrimin të jetës së vërtetë, arti i Pacit është thuarje gjithmonë përfundim artistik i një përvoje të përjetuar.



Këtu dhe djathtas dy sekuenca nga "CPT - Centro di Permanenza Temporanea" ku të huajat në një aeroport ngjisin shkallët e një avioni që s'do t'i marrë kurrë

vijon nga faqja 11

perëndimore pas viteve '90. Ka qenë një kontakt i mbushun me tensione, mbushun me dëshira, me iluzione e zhgënjime, nuk ka qenë një kontakt normal, por i kushtëzuar nga mungesa 50-vjeçare e marrëdhënieve me këtë pjesë të botës. Nga ana tjetër, kjo mungesë dhe kjo dëshirë e ka rritë edhe intensitetin e këtij kontakti.

Po sot, çfarë ka mbetur në punët e tua prej shkollës shqiptare?

Eksperienca ime në shkollë në Shqipëri, si çdo eksperiencë që ka të mirat e të këqijat e veta, sigurisht ka

pasë edhe ajo anët e veta pozitive, madje mundem me thanë se edhe kufizimi në vetvete ka anën e vet pozitive. Problemi është kur ngelesh viktimë e kufizimit. Nga ana tjetër formimi që kam marrë në shkollë më ka shërbye jo vetëm për faktin që unë kam vazhduar të merrem me pikturë, por dhe mënyra se si unë e ndërtoj fotografimin ose si inkuadroj një skenë në video, mbetet e influencuar nga edukimi im prej piktori. Por nuk do të thoja që kjo ka të bëjë me artin shqiptar, kjo ka lidhje kryesisht me të konsideruemit të artit klasik si model.


Përse u përket tematikave, në punët e tua shihet një larmi tematikash që shkojnë që nga karakteristikat e kulturës shqiptare deri tek pozicioni i shqiptarit migrues, e kam fjalën për Vajtojcat, për Back home, si mund të përkufizohet prirja jote për zgjedhjen e tematikave?

Vepra është një realitet kompleks ku tema, forma, ritmi etj. jetojnë në një harmoni intime dhe është e vështirë, për mos me thanë e pamujtun, me i nda nga njena tjetra. Unë nuk i vendos në tavolinë tematikat e punëve të mia. Nganjëherë një eksperiencë e

SI LIND NJË VEPËR ARTI

Turn-on

"Historia e këtij punimi fillon në 2003 kur u pat organizuar ekspozita Së Bashku-Juntos-Tillsammans, që don me thanë në tre gjuhë "bashkë" e ku merrnin pjesë artistë kubanezë, suedezë e shqiptarë. Kuratorët kërkonin me eksploruar dinamikat mbrenda eksperiencave socialiste, komuniste apo gjithsesi të majta që kishin përshkruar në mënyra të ndryshme këto tre vende. Kishin propozuar një komunikim të hapur nëpërmjet e-mailit e qysh në fillim nisen me u pa shenjat e një situatë të deformuar; suedezët kishin mjaft parë, kubanezët asgjë e shqiptarët mund të siguronin vetëm diçka. Në mes rregullave të financimit për artistët suedezë nga Instituti Suedez i Kulturës ishte edhe ajo që ndalonte kalimin e çfarëdo pjese të buxhetit për artistët e vendeve të tjera. Duke e pa situatën e krijuar mendova me ba një punë pikërisht mbi këtë argument. Meqë në Shqipëri shpesh gjatë ditës mungon energjia elektrike, mendova që puna jeme mund të ishte një grup gjeneratorësh që ofronin energji për punimet e artistëve suedezë. Në shkëmbim ato më paguenin me parat e Institutit Suedez të Kulturës. Kështu që organizuar ky shkëmbim e artistat suedezë kanë vuar në buxhetin e tyre një pjesë për energjinë që i ka kaluar mandej punës teme."





Vepra e Pacit është në ekspozim deri në janar në Smith-Stewart Gallery në New York

jetueme, një imazh që sheh diku, një paragraf libri apo një objekt që të del para syve mund të bahen shkas për lindjen e një pune të re. Nga ana tjetër çdo vepër e mbarueme thërret në skenë veprën e re. Asht si një lloj kalim stafete nga njena tek tjetra ku asnjena nuk e thotë fjalën e fundit por bashkë krijojnë universin nëpër të cilin ka kaluar autori i tyre.

Në këtë kontekst e sheh veten si një artist shqiptar, ballkanik apo , le të themi, global?

Nuk e di si mund të përkufizohen këto identitete. Identiteti formohet në lidhje me realitetin që na rrethon i cili ndon-

jëherë mund të jetë i mbyllun e i vogël, ose mund të jetë një identitet i formuem në raport me problematika ma te gjana e universaliste. Në rastin tim problematika nuk ka qenë as ajo e shqiptarit as ajo e ballkanasit ose universalizmi në vetvete. Problematika që ka shoqruar punën time ka qenë problematika e një individi apo një shoqnie te tanë e cila jeton një moment transformimi, që ndërron pikat e veta të referimit dhe momenti i transformimit të identitetit asht një moment universal në vetvete. Problemi nuk është as identiteti shqiptar as identiteti ballkanik, as universal si identitete te mbylluna, por transformimi i vazh-

dueshem i tyre.

Ti je i gjithpranishëm në shumë ekspozita në gjithë botën, galeri europiane e amerikane të kushtojnë ekspozita personale, e me sa di, në Shqipëri nuk je aq i pranishëm sa gjetkë.

Në Shqipëri, jam i pranishëm, në kuptimin që kam marrë pjesë në disa ekspozita, tek Onufri disa herë, në 2001 kam marrë edhe çmimin e parë. Kam marrë pjesë në dy Bienalet e Tiranës. Kam ekspozuar Albanian Stories, Vajtojçën, Apparizione, Back home, After the Wall. Por të gjithë e dimë se në Shqipëri nuk ekziston një sistem i mirë-

vijon në faqen 14

SI LIND NJË VEPËR ARTI

Flesh Mercedes

Historia e këtij punimi (siç ndodh shpesh me punët e mia) nis mbi bazën e një observimi të rastësishëm. Ishim duke hangër me Giancarlo Politiin e Lino Baldinin në Tiranë gjatë edicionit të parë të Bienales, në një restorant që ishte i famshëm për mishin e qingjit. Ndërsa hamë, ndalon një mercedes (në Tiranë çdo tre makina, dy janë mercedes), hap derën e bagazhit, nxjerr prej aty tre qingja të therun e i shkarkon në restorant. Ishte një skenë që duhej ta transformoja patjetër në një punë e kështu lindi "Flesh Mercedes". Për makinën Edi Muka mori në telefon një shok të vetin e i kërkoi se "për kauzën e artit shqiptar" ishte i gatshëm me na dhanë mercedesin e ri pa e ditë se çka bajshim me të. Ai pranoi. Mandej doli problemi i mishit. Nuk kisha shumë pare për me ble të gjithë mishin që kishte me mbushë makinën e gjithsesi kisha nevojë vetëm për dy orë. E kështu me një tjetër mik, shpikëm termin "mish me qera" e dolëm nëpër kasapë që shesin mish jashtë në rrugë duke kërkuar nëse ndonjëni ishte i predispozuem me na dhanë mish me qera. Pat kenë një aventurë e bukur e në fund ia dolëm me e ba fotografinë. Ky asht një ndër punimet e mia ma të ashpra, por ndoshta isha i lodhun me portretizimin që më bahej në tone melankonike e kisha nevojë për diçka tjetër



“Marrëdhania ime me Shqipninë është një marrëdhënie reale dhe unë nuk i iki kësaj marrëdhënie. Unë e përballoj atë por përballoj edhe shkeputjen prej saj. Për me qenë ma i saktë mund të thona se në punët e mia ka aq Shqipni sa ç'ka edhe ikje nga Shqipnia. Është njëkohësisht e pranishme toka nga unë vij aq sa ç'është e pranishme mungesa e tokës.

vijon nga faqja 13

filltë arti. Ekziston vetëm një Galeri kombëtare dhe nuk ka shumë institucione, artistike. Galeria nga ana e saj ka shumë probleme finaciare kështu që nuk mund të mendohet që të organizohen ekspozita personale të shpeshta dhe të kushtueshme. Unë jam i kënaqun me dialogun që kam pasë me Shqipninë, nga ana artistike, ma vonë sigurisht mendoj se kam me pasë raste të tjera për me ekspozue.

Si pritet arti yt shumë-planësh në Shqipëri?

Mendoj se në përgjithësi nuk ka pasë probleme me komunikimin e punëve të mia në Shqipni, por nga ana tjetër unë nuk mund ta di me saktësi si pritet një vepër. Artisti e ban punën e vet, vijnë opinione pozitive, opinione negative, ka mendime nga më të ndryshmet. Në përgjithësi mendoj se punët e mia nuk janë vepra të mbylluna, që mund të lexohen vetëm nëpërmjet një niveli, por janë vepra që mund të lexohen qoftë prej një publiku të rafinuem nga ana estetike qoftë prej një publiku të thjeshtë. Nuk duhet pa tjetër të bash një shkollë arti për tu gjendur përballë një pune time. Dhe kjo mendoj unë është e randësishme, që mos të ketë vetëm një nivel perceptimi. Për mue është e randësishme që vepra të jetë e hapun karshi interpretimeve dhe sugjerimeve të ndryshme që mund të lindin përballë saj.

Ka disa artistë shqiptarë që veprojnë në fushën tënde. E kam fjalën për Anri Salën, për shembull. A mendoni se vihet re ndonjë



ALBANIAN STORIES, 1997

Ndoshta gjithçka ka nisë me "Albanian Stories" ku vajza ime Jolanda, atëherë 3 vjeçe, tregon përralla lojave të saja duke përzënë fantazinë e vet me memoret dramatike të kaosit shqiptar të 1997-s. Aftësia me ndejtë në kapërcyell mes tragjedisë dhe lojës, vetë akti i tregimtares së përrallave që vjen nga një e kalueme e largët dhe spontaniteti e freskia me të cilën vogëlushja veheet në lojë kanë qenë momente që kanë lanë gjurmë në krejt vepren teme. Asht e vërtetë se lidhja njerëzore është e randësishme në të gjitha këto punë që ti përmend. Vitet e para në Itali kanë qenë vite të një pasigurie të madhe e munda për mbijetesë e, siç mendoj se është normale për një prind, vëmendja ndaj fëmijëve ka zanë një pjesë të madhe të preokupimeve të mia. Por përtej kësaj ndoshta ka në mue një tërheqje drejt një mënyre qenëje njerëzore të brishtë e vulnerabel e këtu atëherë zgjedhja e fëmijëve është si edhe e grues plakë në videon "Slowly" galeristat që e lanë vedin me u manipulue në "I love the galleries and they love me", të papunët që mbajnë në dorë një llampë në "Turn On", imazhi i Marisë që largohet nga Shqipnia për mos me ra në duert e turqve në "pilgrIMAGE", saga e pafund e Klodit e kështu me radhë."

Ky tekst dhe ai i dritareve "si lind një vepër arti" u shkëputën nga një intervistë e Adrian Pacit dhënë kritikës së njohur Angela Vettese.

Tre panele me afreskë të Pacit në ekspozim deri në fund të janarit në galerinë Peter Blum Chelsea në New York. Pikturat paraqesin pamje nga një dasmë shqiptare pikturuar në një mur të suvatuar tullash të mbajtura nga trarë druri. Në sallën tjetër të galerisë shfaqet videoja e njohur e Pacit, Vajtojca (2002) ku artisti shtrihet i vdekur për të dëgjuar gjëmën e tij kënduar nga vajtojca e paguar e më pas çohet t'i shtrëngojë dorën.



prirje e përbashkët e artistëve shqiptarë? Si gjendet një art i tillë në Shqipëri sot?

Asht e vështirë me përcaktue rrymat kur ato sapo lindin. Në artin shqiptar nga viti '95 instalacioni apo videoja ishin risi absolute, përdorshin për herë të parë. Në nivel evropian ose botnor, këto janë teknika që janë futë shumë ma parë . Fakti që përdoret videoja , fotografia ose instalacioni, nuk ban ma tendencë. Tani problemi asht se si mund ta përdorësh videon, instalacionin apo fotografinë. E reja sot nuk asht ma tek teknika, madje problemi nuk asht ma as e reja në vetevete por sa intensive, sa cilësore dhe intriguese asht ajo që thuhet. Edhe në Shqipni njerëzit janë çlirue nga ky problem. Nuk ban ma përshtypje çfarë mjeti përdor.

Ka një prirje disi të stisur për mënyrat e reja?

Mendoj se ka një lloj kuri-ziteti dhe një lloj interesi për t'i përdorë gjithsesi, por them se ky interes ka ra disi. Videoja në artin shqiptar mbetet akoma një mjet i ri dhe duke qenë i tillë, asht ma tërheqës, por mendoj se ka shumë artistë sot në Shqipni që përdorin mjete nga ma të ndryshmet, por e theksoj se vlera nuk qëndron tek mjeti.

Si të njohin në botën e artit? Personifikohesh në bazë të rrymës, tematikës, apo edhe apo në bazë të prejardhjes socio-kulturore si emigrant e si shqiptar?

Në shoqinë e komunikimit siç asht kjo e jona ka një prirje për me identifikue nëpërmjet klisheve. Asht një tundim i madh. Unë jam ma i interesuem për vibrationet, për kapërcimet, për tensionet se sa për përcaktimet. Më intereson ma tepër kur mungon konturi

vijon në faqen 17

**SI LIND NJË VEPËR ARTI
 THE PRINCESS**

"The Princess", asht një lloj homazhi ndaj andrrave e dëshirave të vajzës seme, Jolandës. Unë punoja si restaurator në një kështjellë të Viskonteve e kur një ditë ajo erdhi me mue me vizitue kështjellën, mbeti e mahnitun prej ambjenteve madhështore mbushë me afresqe e ornamente. Duke dalë prej pallatit më kthehet e më thotë: a mundesh me m'premtue diçka? A mund të më premtosh se kur të mbarojnë punimet ke me ma ble këtë kështjellë se m'kande me kenë si princeshë mbrenda saj? Ups... ishte me të vertetë diçka impenjative, kështu që i premtova që për një ditë mund ta rregulloja që ajo te hynte në këtë kështjellë si princeshë. E kështu u vesh e u rregulloje e bani lojën e saj. Ajo fotografi asht dëshmi e asaj dite. Duket si një princeshë e vogël e dalun prej tabllave të Velasquezit, në mes të skenës së teatrit të vogël të Viskontëve në një pozë monumentale e njëkohësisht prekëse ."



vijon nga faqja 15

që e përcakton në mënyrë statike. Personalisht nuk jam shumë i interesuem që të identifikohem. Më pëlqen të jem gjithmonë në kapërcyell, midis situatave të ndryshme.

Në këtë natyrë hibride, sa Shqipëri ka në artin tënd?

Ka shumë Shqipëri në veprat e mia. Ky është një fakt evident. Por nëse ndalemi këtu atëherë thuhet se Adrian Paci është një artist që merret me tematikën e Shqipërisë. Këtu fillon vështrimi sipërfaqësor sepse merret ajo çka është evidente dhe nuk kërkohet asgjë përtej saj. Kur unë relizoj një video si "Vajtojca" marr një vajtojce nga Shqipëria e trajtoj diçka që ka lidhje me realitetin nga unë vij. Por nëse hapim problemin përtej kësaj dhe shohim marrëdhëniet që ka njeriu me ritin, me lojën, me vdekjen, me vajin, me ringjalljen, këto janë marrëdhënie që kalojnë përtej Shqipërisë dhe e bajnë veprën interesante për një kategori shumë më të gjerë njerëzish se ata të cilët janë të interesuem thjesht për traditat historike të Shqipërisë së Veriut. Ka shumë Shqipëri në veprat e mia por problemi nuk është kurrë Shqipëria.

Marrëdhënia ime me Shqipërinë është një marrëdhënie reale dhe unë nuk i iki kësaj marrëdhënie. Unë e përballoj atë por përballoj edhe shkeputjen prej saj. Për me qenë ma i saktë mund të thona se në punët e mia ka aq Shqipëri sa ç'ka edhe ikje nga Shqipëria. Është njëkohësisht e pranishme toka nga unë vij aq sa ç'është e pranishme mungesa e tokës.

Bisedoi Marjola Rukaj



Dy pamje nga videoinstalacioni "Per speculum" i cili e merr titullin nga Letra e Korinthisve e Shen Palit, e nga ku e tërë mesjeta nisi ta interpretojë realitetin si simbol, dhe natyrën si një thurje alegorike ku ishte fshehur e vërteta e Zotit. Termi "speculum" bëhet kështu teknik dhe detyrë e njeriut është të lexojë, të gjejë çelësin interpretues të vullnetit hyjnor. Elementi hyjnor gjendet shpesh i ndërkallur në një shtresë të thellë në disa vepra të Pacit.



PER SPECULUM OSE SPEKULLIMI I PASQYRËS

Krahasuar me punët e tjera, "Per Speculum" nuk merr nismë nga një ngjarje konkrete, por duket i vendosur pezull në një vend me karakter arketip.

Protagonistë janë një grup fëmijësh të cilët pasi kanë shkatërruar pasqyrën ku reflektohet imazhi i tyre, përdorin copëzat për t'i thurur një sfidë lozonjare diellit. Të varur në degët e një peme të stërmadhe fëmijët reflektojnë me pasqyrëzat dritën, duke i dhënë bimës një gjallëri pulsuese. Pas thyerjes së pasqyrës, një veprim në vetvete dramatik, vetëshkatërrues, vijon papritur gjesti çlirues i lojës, e bashkë me të, një përmbysje perspektive që bën që rrezet e dritës të drejtohen drejt spektatorit, që ndihet si të ishte i përfshirë në skenën e gjallë. Imazhet e filmit megjithëse kërkojnë të ruajnë një karakter të lehtë, janë të ndërthurura me kuptime të holla simbolike, që shpalosin hapje të ndryshme interpretuese, duke nisur nga pasqyra, thyerja e të cilës në shumë kultura është fatkeqësi sjellëse, por që këtu bëhet mjet loje, e më shumë se kaq edhe njohjeje. Titulli i punës i referohet një fjalie shumë të komentuar të letrës së parë të Shën Palit Korinthisve, *videmus nunc per speculum in aenigmate, tunc autem facie ad faciem* 13:12 (tani shikojmë si në një pasqyrë, turbullt; por pastaj do të shikojmë fytyrë më fytyrë), në të cilën flitet për temën e njohjes njerëzore, që është e kufizuar vetëm me një pikëpamje, pikërisht "spekullore" (pasqyrore), jo të drejtpërdrejtë. Por në film pikërisht kjo pasqyrësi, ky ndërmjetësim në aspekt zbatimës që mundëson përcjelljen e bukurisë në elementin e thjeshtë natyror. Nga ana tjetër e njëjta pemë, e paraqitur në mënyrë të përballeshme me gjithë madhësinë e saj, kujton ikonografi të shumta, që nga pema e Jesse, tek pema filozofike, e deri tek pema si simbol jete dhe i gjenealogjisë: pema si strukturë sistematike dhe e gjallë, që është në gjendje të mbajë dhe të bashkojë shumësinë.

Krahas filmit janë edhe të tjera punime: një fotografi që paraqet një godinë pamjerëndë të braktisur në një sfond rural dhe të shkretët, por të gjallëruar nga pika drite të fortë, verbuese me burim të paqartë. Sërish loja e pasqyrave çorienton dhe në të njëjtën kohë u jep vendeve një bukurri arkaike, bukurinë e dritës. Dritë që ndërhyjnë edhe në mediumin e disa punimeve: në projektimin në film edhe në përmbledhjen slide-show të imazheve të marra nga punimi i videos burimi i dritës bëhet i qartë, duke një kthim spekullor (pasqyror) ndërmjet projektimit dhe imazhit.